



Më  
Dana 25 - 06 - 2018

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ-DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM-DIVIZIONI PENAL**, me gjyqtarin Elmaz Zenuni dhe zyrtarin ligjor Gazmend Bytyqi, në çështjen penale kundër të akuzuarit [REDACTED] nga Ferizaji, Rruga [REDACTED] pa nr., i akuzuar me aktakuzën e Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/II.nr.272-3/18 të dt. 19.03.2018, sipas së cilës e ka kryer veprën penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par pik 6 lidhur me par.1 të KPRK-së duke vendosur rreth kërkesës për dhënien e urdhërit ndëshkimor, pa e mbajtur shqyrtimin gjyqësor, më dt. 27.04.2018 merr:

### AKT GJYKIM

**APROVOHET** kërkesa e Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/II.nr.272-3/18 të dt. 19.03.2018, dhe gjykata jep këtë:

### URDHËR NDËSHKIMOR

I akuzuari: [REDACTED] nga Ferizaji, Rruga [REDACTED] pa nr., i lindur me datë, [REDACTED] në Ferizaj, nga i ati [REDACTED] e e ëma [REDACTED] e gjinisë [REDACTED], ka të kryer shkollën e mesme, me profesion rrobaqepëe, shtetas i Republikës së Kosovës, mbrohet në liri, posedon numrin personal [REDACTED]

### ËSHTË FAJTOR

Sepse me datë 20.12.2017 rreth orës 19:13, në rrugën publike "Vëllëzërit Gërvalla" në Ferizaj, duke drejtuar automjetin e udhëtarëve të tipit "Fiat Punto" me targa të regjistrimit [REDACTED], në kundërshtim me nenin 45 par.1 dhe nenit 53 të LRRTRR, nga pakujdesia ndërmerr veprimet e kyqjes në rrugën "Avdullah Gashi" pa u bindur se mund të i pengoj pjesëmarrësit e tjerë në komunikacion, ku me pjesën e përparme e godet nga pjesa e pasme automjetin e tipit "Peugeot 207" me targa të regjistrimit [REDACTED] të cilin e drejtonte [REDACTED] ku nuk ka përshtatur edhe shpejtësinë e lëvizjes dhe kushteve në

rrugë,ashtu që në atë aksident komunikacioni pos dëmeve materiale në vetuar lëndime të lehta trupore me pasoja të përkohëshme pëson [REDAKTUAR] dhe pasagjerja e tij [REDAKTUAR] të përshkruara në Ekspertizën mjeko ligjore të dt.17.02.2018,-

*- me të cilën kreu veprën penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par pik 6 lidhur me par.1 të KPRK-së,*

Andaj, gjykata në bazë të neneve: 4, 7, 17, 41, 43, 46 dhe 73 të KPRK-së dhe neneve 365 e 495 të KPPRK-së i shqipton:

### **DËNIM ME GJOBË**

Të akuzuarit [REDAKTUAR], i shqiptoi dënimin në shumën prej 200 € (dyqind Euro), të cilën shumë i akuzuari obligohet ta paguaj në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nëse dënimi me gjobë nuk mund të ekzekutohet në format tjera sipas nenit 46 par.3 të KPRK-së, i njëjti do t'i shndërrohet në dënim me burg ashtu që për çdo 20 Euro, do t'i llogaritet nga një (1) ditë burg.

Gjykata të dëmtuarit : 1. [REDAKTUAR] i nga fshati [REDAKTUAR] Komuna e Gllogovcit dhe 2. [REDAKTUAR] nga Prishtina, Rruga '[REDAKTUAR]' pa nr., për realizimin e kërkesës pasuroro-juridike i udhëzon në kontest civil.

Obligohet i akuzuari që në emër të shpenzimeve procedurale 60.88 € dhe paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 €, në afat prej 15 ditëve, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

Konform nenit 39 par.3.1 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit –Ligji nr.05/L-036, Obligohet i akuzuari që në emër të Taksës për Kompensimin e Viktimave të Krimit të paguaj shumën prej 30 eurove, në afat prej 15 ditëve, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.

### A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Ferizaj me aktakuzën PP/II.nr.272-3/18 të dt. 19.03.2018, ka akuzuar [REDAKTUAR] nga Ferizaji, Rruga [REDAKTUAR] pa nr., për veprën penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par pik 6 lidhur me par.1 të KPRK-së dhe të njëjtën ditë ka parashtruar kërkesën për dhënien e urdhrin ndëshkimor kundër të akuzuarit me arsyen se ka prova të besueshme që vërtetojnë kryerjen e kësaj vepre penale nga i njëjti.

Gjykata gjatë shqyrtimit paraprak të aktakuzës dhe kërkesës për dhënien e urdhrin ndëshkimor, në vështrim të nenit 495 parag.1, 2 dhe 3 të KPPRK-së, gjeti se janë plotësuar kushtet ligjore për aprovimin e kërkesës për dhënien e urdhrin ndëshkimor.

Nga provat materiale të bashkëngjitura në shkresat e lëndës gjegjësisht konstatimin e Ekspertit mjeko ligjor i dt.17.02.2018, mendimi i Ekspertit të komunikacionit i datës 23.01.2018, raporti mjekësor nga Qendra Emergjente – Spitali në Ferizaj nr.355 dt.20.12.2017, si dhe fotografitë të cilat gjenden në shkresat e lëndës, gjykata ka konstatuar se këto prova janë të bazuara dhe bindëse, sepse vërtetojnë që i akuzuari e ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet, andaj gjykata e shpalli fajtor dhe i shqiptoi dënimin me gjobë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata, konform nenit 463 par.1 lidhur me par 3 të KPPRK-së të dëmtuarit: 1. [REDAKTUAR] nga fshati [REDAKTUAR] Komuna e Gllogovcit dhe 2. [REDAKTUAR] nga Prishtina, Rruga [REDAKTUAR] pa nr., për realizimin e kërkesës pasuroro-juridike janë udhëzuar në kontest civil.

Konform nenit 450 par.2.6 të KPPK-së obligohet i akuzuari që në emër të shpenzimeve gjyqësore të paguaj shumën prej 60.88 Euro, si dhe paushallin gjyqësor në shumën prej 20 €, të gjitha këto në afat prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.


Njashtu, Konform nenit 39 par.3.1 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit –Ligji nr.05/L-036, Obligohet i akuzuari që në emër të Taksës për Kompensimin e Viktimave të Krimit të paguaj shumën prej 30 eurove, në afat prej 15 ditëve, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.

Nga sa u tha më lart është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

### **GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ**

**P.nr.405/2018, dt. 27.04.2018**

**Zyrtari Ligjor  
Gazmend Bytyqi**

**Gjyqtari,  
Elmaz Zenuni**  


#### **UDHËZIM JURIDIK:**

Kudër këtij aktgjykimi lejohet kundërshtimi në afat prej 8 ditësh, nga dita e pranimit të dërgesës së njëjtit, gjyqtarit të vetëm gjykues të kësaj gjykate, përmes kësaj gjykate.

Pas skadimit të afatit të lejuar për kundërshtim, urdhëri ndëshkimor bëhet i plotfuqishëm dhe ekzekutohet dënimi i shqiptuar.